



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2019:140212

Datë: 24.07.2020

Numri i dokumentit: 01038556

**C.nr. 103/18**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, Gjyqtari Fatmir Baloku, në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditëses D.A nga Peja të cilën e përfaqësojnë A..SH.P.K. të cilën e përfaqësojnë Z.I, A.I, A.K, J.I dhe L.B të gjithë avokat nga Prishtina kundër të paditurës K.P të cilën e përfaqëson me autorizim në shkresa të lëndës zyrtari ligjor F. I nga Peja, me bazë juridike kompensim i pagave për përcjellje në pension dhe kompensim i shpërblimeve jubilar, vlera e kontestit 2573.76 euro, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesorë me datë 10.07.2020, jashtë seancës me datë 24.07.2020, bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. DETYROHET** e paditura K.P, që paditëses D.A nga Peja, të i bëjë kompensimin e shumave siç vijon dhe atë :

- në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, të i paguajë shumën prej 1,286.88 euro,
- në emër të kompensimit të pagave përcjellëse shumën prej 1,286.88 euro,

me kamatë në lartësi prej 8 % për ty dy shumat e gjykuara, nga dita e vendosjes dt.24.07.2020 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 279 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

## A r s y e t i m

Paditësja në këtë gjykatë nëpërmjet të autorizuarit të tij me datën 02.02.2018 ka parashtruar padi me bazë juridike kompensim i shpërblimit jubilar dhe kompensim i pagave përcjellëse, duke kërkuar kompensimin në emër të shpërblimeve të lartcekura, ndërsa me datën 28.02.2020 ka parashtruar parashtrësë për rregullim të padisë dhe kërkesëpadiisë, duke bërë precizimin në kuptim subjektiv të padisë, ashtu që ka kërkuar që të i aprovohet padia dhe kërkesëpadiia dhe të detyrohet Komuna e Pejës – Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Pejë për kompensim të shpërblimit jubilar dhe pagat përcjellëse në gjithsejtë shumën 2573.76, si dhe shpenzimet e procedurës e të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, me kamatë 8%.

E paditura K.P në përgjigjen në padi të parashtruar në gjykatë, ka kundërshtuar padinë dhe kërkesën e saj duke cituar se është pa mbështetje ligjore ligjore, juridike dhe faktike, duke mos përmbajt elementet thelbësore të padisë, nuk përmban prova të pretendimeve faktike, se e paditura ka obligim material ndaj paditëses për pagesë të shumave të kërkuara, duke i munguar të paditurës legjitimiteti real pasiv në këtë procedurë gjyqësore, duhet theksuar se kërkesa për pagesë të pagave jubilarë është parashkruar ngase sipas dispozitave të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, i punësuari ka të drejtë në realizimin e pagës jubilarë për çdo 10 vite përvojë pune, kurse afati ligjor për një kërkesë të tillë është 3 vite pas kalimit të çdo periudhe 10,20,30,40 dhe nuk mund të realizohet pas pensionimit në mënyrë retroaktive, ndërsa sa i përket pagave përcjellëse paditësi, padinë dhe kërkesëpadinë e tij është dashur të e drejtojë ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës si garantuese e përmbushjes së obligimeve financiare lidhur me të drejtat që rrjedhin nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive të datës 18.04.2014 të nënshkruar mes OEK, Aleancës Kosovare të Biznesit, BSPK, dhe Qeverisë së Kosovës – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke kërkuar që të refuzohet në tërësi padia si e pabazuar.

I autorizuari i palës paditëse në seancë dhe fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet pranë padisë përkatësisht rregullimit dhe ndryshimit në kuptimin subjektiv të datës 28.02.2020, duke propozuar nxjerrjen e provave, ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi se mbesim në tërësi si në thëniet e lartcekura duke propozuar që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet si e bazuar po ashtu i kërkojmë shpenzimet e procedurës.

I autorizuari i palës së paditur në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbesim në tërësi pranë padisë, thëniet të dhëna në përgjigje në padi, duke e kundërshtuar padinë sepse nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se i padituri ka obligim pagese përcjellëse për tri paga përcjellëse në pension dhe shpërblim jubilar, duke i munguar legjitimiteti real pasiv në këtë procedurë gjyqësore, sa i përket kërkesës për pagesë të pagave jubilarë theksojmë se një kërkesë e tillë është parashkruar ngase sipas dispozitave të kontratës së përgjithshme kolektive punësuari ka të drejtë një pagë jubilarë për çdo 10 vjet pune kurse afati ligjor për një kërkesë të tillë është 3 vite pas kalimit të çdo periudhe 10,20 apo 30 vjeçare dhe si e tillë nuk mund të realizohet pas pensionimit në mënyrë retroaktive sepse neni 353 i LMD-së dhe neni 87 i Ligjit të Punës thekson se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen në afat prej 3 vitesh dhe pasi e njëjta ka 33 vite e 5 muaj përvojë pune e njëjta duhet konsideruar si e parashkruar. Sa i përket pagave përcjellëse paditësi padinë është dashur të i' a drejtojë Qeverisë së Kosovës si garantuese e përmbushjes së obligimeve financiare lidhur me të drejtat që rrjedhin nga marrëveshja e përgjithshme kolektive e nënshkruar në mes të Odës Ekonomike AKB,BSPK dhe Qeverisë së Kosovës – Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke kërkuar refuzimin e padisë në tërësi si të pabazuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata në shqyrtim kryesorë dhe sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova: Vendimi i QKMF në Pejë nr.1405/1 datë 01.12.2017, kërkesa e drejtuar QKMF-së nr.1573/1 datë 28.12.2017, kopja e librezës së punës, lista e rrogave muaj shtator 2017, pasqyra bankare datë 28.12.2017, kontrata e punës nr.1471/12 datë 31.12.2012,shkresa – përshkrimi i vendit të punës lëshuar nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – Mjekësia Familjare, aplikacioni për tërheqje të kursimeve pensionale datë.04.12.2017, pasqyra e llogarisë datë 29.11.2016 deri më 29.11.2017, kopja e kartelës bankare, vërtetimi i QKMF në Pejë nr. Protokollit 232/1 datë 13.02.2020.

Pas vlerësimit të provave veç e veç e të gjitha në lidhshmëri reciproke e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – civile

kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vërtetuar gjendjen faktike siç vijon :

Nuk është kontestues fakti se paditësja D.A nga Peja, ka qenë e punësuar në vendin e punës Infermiere e Përgjithshme në kuadër të QKMF-së në Pejë, derisa i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datën 19.12.2017 për shkak të mbushjes mandatorë të pensionit 65 vjet, me përvojë pune 33 vite , 5 muaj e 2 ditë.

Nuk është kontestues fakti se pas arritjes së moshës së pensionimit paditësja i është drejtuar Drejtorisë së Institucionit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Pejë me kërkesë për pagesën e tri pagave në emër të shpërblimeve jubilarë dhe kompensim në rast të pensionimit duke kërkuar rimbursim, mirëpo nuk ka marrë përgjigje.

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Në nenin 4 par.2 të Ligjit të Punës (Nr.03/L-212) i cili ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditëses D.A parashihet se “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”. Ndërsa në nenin 67 të këtij ligji parashihet se “1.Kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet: 1.4. kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç”. Po ashtu në nenin 90 të këtij ligji parashihet se “1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. nivel të vendit,2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes.3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”. Po ashtu në nenin 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015, parashihet se: “I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij.

Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni parasheh se “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë” dhe se paragrafi 3 i këtij neni parasheh se “Shpërblimi jubilar,

paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragrafi”, ndërsa neni 53 i po kësaj marrëveshje parasheh që i punësuar ka të drejtë në tri paga me rastin e pensionimit, në rastin konkret paditësja D.A në kohën kur ka dal në pension më datën 19.12.2017 Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka qenë e zbatueshme në këtë kohë kur paditësja ka fituar kushtin për kompensim të këtyre shpërblimeve.

Bazuar në këtë marrëveshje përkatësisht në nenin 4 par 1 të kësaj Marrëveshjeje përcaktohen se “dispozitat e MPKK i obligojnë punëdhënësit të cilët, në çfarëdo mënyre, kryejnë veprimtari ekonomike, joekonomike dhe shërbime civile. Marrëveshja Kolektive, mund të lidhet edhe në nivel të Degës dhe të Ndërmarrjes. 2. Degët e sindikatave të veprimtarive joekonomike (shërbimet civile, publike dhe ndërmarrjet publike), lidhin kontratë të posaçme me punëdhënësit e tyre (ministritë përkatëse, atë të Administratës Publike, Arsimit, Shëndetësisë, etj), në pajtim me specifikat e tyre”.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë gjykata e vërtetojë përvojën e punës së paditëses me vërtetimin nr.232/1 të datës 13.02.2020, lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, ashtu që vërtetohet se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune prej vitit 1984 deri në vitin 2017 duke përcaktuar shpërblimin jubilar në lartësi të tri pagave ashtu siç ka vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa sa i përket për shpërblimin e tri pagave përcjellëse është bazuar në Pasqyrën e llogarisë bankare datë 29.11.2016 deri më 29.11.2017, ku vërtetohet se tre muajt e fundit paditësja ka pas të ardhura mujore në vlerë prej 428.96 euro.

Gjykata nuk pajtohet me pretendimin e palës së paditur që garantuese e përmbushjes së obligimeve financiare nga kërkesëpadia e paditëses përkatësisht për paga përcjellëse është Qeveria e Republikës së Kosovës sepse Drejtorati i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë përkatësisht në nenin 62 përcakton se “Drejtoritë komunale janë Drejtori të udhëhequra nga drejtorët përkatës që emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës”.

Nuk qëndrojnë pretendimet e lartcekura sepse paditësja ka qenë në marrëdhënie pune në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Pejë, ashtu që neni 2 i Statutit nr.03/2016 të kësaj Qendre përcakton se themelues i QKMF-së është Kuvendi Komunal ne Pejë, e duke u mbështetur në të lartcekurat obligimi bie mbi Komunën e Pejës –Drejtoratin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale që të bëjë realizimin e kërkesave të paditëses, duke pas legjitimitet real pasiv në këtë çështje.

Gjykata i shqyrtojë edhe pretendimet e palës së paditur të cekura në përgjigje në padi dhe në seancë të shqyrtimit kryesorë duke cekur se kërkesa për shpërblime jubilarë është parashkruar, mirëpo të njëjtat nuk kanë pas ndikim që gjykata të vendos ndryshe nga siç ka vendos në dispozitivin e këtij aktgjykimi, sepse kërkesa për shpërblim jubilar i takon paditëses, ngase e njëjta marrëdhënien e punës e ka filluar me datë 17.07.1984 duke e përfunduar me datë 19.12.2017, duke fituar të drejtën e pagesës së shpërblimeve jubilarë në momentin e pensionimit, ndërsa afati për pagesë të këtij lloji shpërblimi vlen për të paditurën, e cila është e obliguar që të paguajë shpërblimet e tilla,

sepse sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive përkatësisht nenit 52 përcaktohet qartë 'punëdhënësi i fundit të bëjë pagesën' e që i bie e paditura.

Vendimin mbi kamatën gjykata e ka vendosur duke u bazuar në nenin 382 par 1 dhe par 2 të Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve.

Gjykata vendosi sa i përket shpenzimeve të procedurës konform nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, duke e detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompensojnë shpenzimet e procedurës dhe atë për: taksë për parashtresën mbi rregullimin e padisë dhe kërkesëpadisë të padisë në shumën prej 104 euro, për përfaqësim në një seancë gjyqësore 135 euro, për taksë gjyqësore të padisë shumën prej 40 euro gjithsejtë 279 euro, shpenzime këto të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës, e të cilat janë specifikuar edhe në seancës e datës 10.07.2020.

Prandaj nga të lartcekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË datë 24.07.2020**

**Gjyqtari**

**Fatmir Baloku**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa, në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së këtij aktgjykimi, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.